



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Për :</b>	<b>Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë</b> <b>Nasuf Aliu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë</b>	
<b>Cc:</b>	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	<b>Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së</b> <b>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së</b>	
<b>Nga:</b>	<b>Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe</b> Monitorim të Komunave MAPL	<b>Datë:</b> 09/07/2018
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	020-802
<b>Lloji i aktit:</b>	Vendim	

I/e nderuar Kryetar,  
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 174/18 për miratimin e nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë
I miratuar më datë: 28.06.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.07.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Za:	Xhafer Tahiri, gradonačelnik opštine Vučitrn Nasuf Aliu, predsedavajući Skupštine opštine Vučitrn	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>zo. B.F.</i> Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a <i>[Signature]</i>	
Od:	Shkelqim Jakupi, rukovodilac pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS <i>[Signature]</i>	Dana: 09/07/2018 020-802
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Vučitrn	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelniče,  
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.174/18 za usvajanje inicijative za izmenu i dopunu Statuta opštine Vučitrn
Usvojena dana: 28.06.2018. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 03.07.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Bazuar në nenin 12 nën "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 41.2, pika "ç" dhe nenin 92, paragrafi 1, pika a të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2018, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIM TË NISMËS PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT**  
**TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim miratohet nisma e Kryetarit të komunës, 02 Nr.799-1/18 e datës 8.6.2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrisë 01nr. 58/11, datë 28.4.2011.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të komunës do t'i hartojë komisioni i cili formohet me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Nasuf Aliu

\_\_\_\_\_  
Kryesues i Kuvendit

799-1/19

08.06.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PEC:	Kuvendi i Komunës z. Nasuf Aliu, Kryesues i Kuvendit të Komunës
PËR NJOFTIM: PËRMES: NGA:	Xhavit Dahu Kryetar i Komunës Nismë për ndryshim dhe plotësim të Statutit të komunës
TEMA:	

Falënderim kryesues i Kuvendit të komunës.

Në pajtim me nenin 92 paragrafi 92.1, nën a) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë datë 28.04.2011 paraqes këtë

Nismë  
për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Vushtrrisë

Propozim vendimin për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Vushtrrisë kërkoj që të fism në rend të ditës të mbledhjes së radhës të kuvendit të komunës

Propozoj gjithashtu që pas aprovimit në kuvend të nismës për ndryshim dhe plotësim të statutit të formohet komisioni për hartim të ndryshimeve dhe plotësimeve të statutit në përbeje: tre anëtar nga përbërja e kuvendit të komunës dhe anëtar jashtë përbërjes së kuvendit.

Ju falënderoj paraprakisht.

Me respekt